



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**THIRRJE PËR APLIKIM NË EDICIONIN E TETË TË UNESCO- ÇMIMI
NDËRKOMBËTAR I GUINEAS EKUATORIALE PËR KËRKIM SHKENCOR NË
SHKENCAT E JETËS**

Qëllimi i Çmimit Ndërkombëtar Guinea Ekuatoriale i UNESCO-s për Kërkim në Shkencat e Jetës është të shpërblejë projekte dhe aktivitete të individëve, institucioneve dhe organizatave joqeveritare, të cilat punojmë në fushën e shkencave të jetës duke promovuar cilësinë e jetës. Krijuar nga Bordi Ekzekutiv i UNESCO-s, ky çmim shpërblen projektet shkencore individuale, institucionale, dhe të organizatave joqeveritare, të cilat zhvillojnë kërkim në shkencat e jetës. Juria do të përzgjedhë deri në 3 laureatë, të cilët do të ndajnë vlerën prej \$350,000, për të suportuar dhe avancuar punën e tyre kërkimore.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 31 Tetor 2023 (para mesnate), nga Shtetet Anëtare nëpërmjet Komisioneve Kombëtare në UNESCO, ose nga organizatat joqeveritare në partneritet zyrtar me UNESCO, dhe aktive në fushat e kërkimit. Vendet anëtare ose organizatat joqeveritare mund të nominojnë deri në 5 kandidate për çdo edicion të Çmimit.

Procesi i aplikimit do të kryhet online nëpërmjet linkut: <https://www.unesco.org/en/prizes/equatorial-guinea> . Për më shumë informacion mund ti drejtoheni dhe Sekretariatit të UNESCO Equatorial Guinea për Çmimin Ndërkombëtar për Kërkim në Shkencat e Jetës në adresën: (lifesciencesprize@unesco.org).